



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:032128

Datë: 25.05.2021

Numri i dokumentit: 01812900

**P.nr.1007/18**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**Gjykata Themelore në Prizren** - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Shpresa Emra me pjesëmarrjen e sekretares juridike Birsen Shoshani, në çështjen penale kundër të akuzuarit G.M., nga Prizreni, me numër personal ....., për shkak se ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.1280-7/18 të datës 27.06.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor në prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, Prokurorit të Shtetit Shahadin Destani dhe të akuzuarit, me datë 06.05.2021, publikisht mori dhe shpalli këtë:

## **A K T G J Y K I M**

### **I akuzuari:**

**G.M.**, nga i ati ..... dhe e ëma .....,e lindur ....., i lindur më ..... në ....., i njëjti tani banon në rr. .... pa nr. ka të kryer shkollën fillore, me profesion punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar babë i 2 fëmijëve, shqiptar shtetas i R së Kosovës identifikohet me letër njoftim nr. ...., me nr. tel. ....

## **ËSHTË FAJTOR**

Se me dt. 19.05.2018, rreth orës 20.50 minuta, në fshatin ..... Komuna e Prizrenit, saktësisht afër market ".....", i pandehuri i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit-D.H., në atë mënyrë që pas disa mosmarrëveshjeve të ditës kritike që kishin pasur në lidhje me një aksident trafiku, derisa i dëmtuari ishte duke vozitur automjetin e markës "....." me tr..... në drejtim të qytetit, para tij ishte duke lëvizur i pandehuri dhe në momentin kur i dëmtuari tejkalon të pandehurin, i pandehuri me automjetin e tij fillon ta ndjek, i dëmtuari pasi vëren që i pandehuri me automjetin e tij kishte filluar që ta ndjekë, ndal shpejtësinë, në atë moment i pandehuri e godet prapa në automjet, dhe deri sa i dëmtuari dele nga automjeti për ta shikuar automjetin i pandehuri me një shishe qelqi e godet në kokë dhe largohet nga vendi i ngjarjes, me ç' rast i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore.

**Me këto veprime ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 të KP.**

Andaj gjykata në kuptim të dispozitave të neneve: 7, 8, 9, 10, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73 dhe të nenit 188 par. 2 të KP të akuzuarit ia shqipton:

**DËNIMIN ME BURGIM ME KUSHT**

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **8 (tetë) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohor prej **1 (një) viti** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

I dëmtuari D.H., nga fsh. .... Komuna e ....., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo juridik.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e kësaj procedure penale dhe atë për ekspertizën mjeko - ligjore shumë prej 20.88 Euro, për paushallin gjyqësor shumë prej 20 Euro si dhe në emër të Fondit për kompensim të viktimave shumë prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim e përmbarrimit të dhunshëm.

**Arsyetim**

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate ka parashtruar Aktakuzë, PP/II.nr.1280-7/18 të datës 27.06.2018 kundër të akuzuarit G.M., nga Prizreni, me numër personal ....., për shkak se ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata në këtë çështje penale duke vepruar sipas Aktakuzës ka caktuar shqyrtimin fillestar gjyqësor, ku në shqyrtimin fillestar gjyqësor i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës.

Bazuar në aktin e pranimit të fajësisë dhe konform dispozitave të nenit 246 e 248 të KPP-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Gjykata në shqyrtimin ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me dt. 19.05.2018, rreth orës 20.50 minuta, në fshatin ..... Komuna e Prizrenit, saktësisht afër market ".....", i pandehuri i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit-D.H., , në atë mënyrë që pas disa mosmarrëveshjeve të ditës kritike që kishin pasur në lidhje me një aksident trafiku, derisa i dëmtuari ishte duke vozitur automjetin e markës "....." me tr. .... në drejtim të qytetit, para tij ishte duke lëvizur i pandehuri dhe në momentin kur i dëmtuari tejkalon të pandehurin, i pandehuri me automjetin e tij fillon ta ndjek, i dëmtuari pasi vëren që i pandehuri me automjetin e tij kishte filluar që ta ndjekë, ndal shpejtësinë, në atë moment i pandehuri e godet prapa në automjet, dhe deri sa i dëmtuari dele nga automjeti për ta shikuar automjetin i pandehuri me një shishe qelqi e godet në kokë dhe largohet nga vendi i ngjarjes, me ç' rast i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat.

Sipas detyrës zyrtare gjykata, konform nenit 257 të KPP-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzime. Pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me kohë me të gjitha provat materiale.

Gjykata erdhi në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së dhe faktet që përmban aktakuza, ku në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par. 2 i KP, ku për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me burgim me kusht në kohëzgjatje **prej 8(tetë) muajve** i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin kohor prej **1 (një) viti** nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjatë vendosjes mbi dënimin, gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë të veçantë rënduese e cila do të ndikonte në llojin dhe lartësinë e dënimit, ndërsa si rrethana lehtësuese ka konsideruar: pranimin e fajësisë nga i pandehuri ku në shqyrtim ka deklaruar është e vërtet që ka ndodhur rasti në vitin 2018 dhe e ka goditur vozitësin e automjetit “.....” në fsh. ...., por këtë e ka bërë pasi që i njëjti nga automjeti të cilin e ka goditur nga prapa ka dalur me një shishe dhe në momentin kur ka tentuar që ta sulmoj ai me shishen e tij e ka goditur në kokë. I vjen keq që kjo ka ndodhur dhe ka tentuar që të kërkoj falje, por nuk ka mund të kontaktoj me të dëmtuarin pasi që i njëjti ka dal jashtë shtetit . I premtom gjykatës që nuk do të ndodh diçka e ngjashme në të ardhmen.

Andaj duke u bazuar në këto rrethana, gjykata të akuzuarit i shqiptoi sanksionin penal sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se sanksioni shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale juridike të tij dhe se me këtë sanksion do të arrihet qëllimi preventiv i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontest të rregullt civilë është marrë në kuptim të nenit 463 të KP.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në kuptim të nenit 450, 451 dhe 453 të KPP-së.

Vendimi mbi pagesën e kompensimit për Fondin e Kompensimit të viktimave është marr në kuptim të nenit 6 dhe 39 par.3 pik.1 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensim të Viktimave të Krimit .

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr.1007/18 e dt. 06.05.2021**

**2018:032128, 25.05.2021**

**Gjyqtari**

---

**Shpresa Emra**

**UDHËZIM JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.